KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazna
Nr. 1-30 Br. Data 02.03.2022 Datum

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës, nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, pas shqyrtimit të kërkesës nr.-I-3979, të dt.11.02.2022, pas propozimit të Kryetarit të Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.25.02.2022 , Kuvendi i Komunës mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Vendimi për subvencionimin e kompanive private që operojnë në linjat e transportit publik urban dhe ndërurban në territorin e Komunës së Obiliqit.**

II. **Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtijë Vendimi është 15,000.00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të drejtorisë së DSHPE-së.**

III. **Qëllimi I këtijë Vendimi është dhënia e ndihmës kompanive private që operojnë në transportin publik urban-ndërurban në teritorin e Komunës së Obiliqit, për shkak të situatës pandemike të krijuar nga virusi dhe masave restrictive nga Qeveria e Republikës së Kosovës.**

IV. **Obligohet drejtoria e DSHPE-së dhe drejtoria e DEFZH-së të kompletojnë dokumentacionin e kompanive që operojnë në linjat e transportit publik në Komunën tonë për zbatimin e këtijë Vendimi.**

V. **Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.**

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Kryesueses
-Nënkryetarit
-MAPL
-DEFZH
-Anëtarëve të KK
-Arkivit